



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 26.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.04.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "Jasemin" Sh.p.k. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lule dhe kurora", Nr. i prokurimit- 632-24-1744-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-021-121, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Jasemin" Sh.p.k., e dt.23.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me lule dhe kurora", Nr. i prokurimit- 632-24-1744-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-021-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 19.04.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:19.04.03.2024;
- 3.**Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Jasemin" Sh.p.k., me dt.23.04.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lule dhe kurora", Nr. i prokurimit- 632-24-1744-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-021-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 26.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher-i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

